



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 149, Datë 25.07.2024

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “AGE ERZEN” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 814/13 prot., datë 24.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/3 prot., datë 31.05.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 127, datë 25.06.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 26.06.2024 dhe 27.06.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 05.07.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1641 prot., datë 15.07.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 814/9 prot., datë 28.06.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/10 prot., datë 08.07.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Pas shqyrtimit të sa depozituar, ka rezultuar se mbetet ende dokumentacion për t'u plotësuar, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 814/11 prot., datë 19.07.2024 për plotësim dokumentacioni. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar së fundi në ERE me nr. 814/12 prot., datë 23.07.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Në nenin 14, pika 3 të Rregullores parashikohet se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Me qëllim shqyrtimin dhe analizimin e dokumentacionit të depozituar së fundi nga shoqëria dhe zhvillimin e ndonjë korrespondence të mundshme me të, vlerësojmë të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 20 (njëzet) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “AGE ERZEN” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI